



KB

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 19528 Prot

Vlorë, më 20.11.2025

Lënda: Njoftim për mbledhjen e radhës të Këshillit të Bashkisë, datë 27.11.2025.

ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË BASHKISË VLORE

Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE

PREFEKTIT TË QARKUT VLORE

Ju njoftoj se, **ditën e enjte , date 27.11.2025, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhje e radhës e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryesia e Këshillit, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 4,ku pas ;

- 1.Shprehje për ligjshmërinë e Vendimeve të Këshillit të Bashkisë Nr 80 - 87 , datë 30.10.2025 .
- 2.Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes të Këshillit të Bashkisë, për muajin tetor , datë 30.10.2025.

Do të vazhdojmë me këtë rend dite:

1. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë, për muajin Tetor 2025”.
2. Projektvendim “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Tetor 2025”.
3. Projektvendim “Për Miratimin e Marrëveshjes për Krijimin e Personit Juridik si Subjekt i Kompetencave të Përbashkëta, midis Njësive të Vetëqeverisjes Vendore dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, për Rritjen e Kapaciteteve të Qeverisjes Vendore, Akademia e Trajnimit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore të Republikës së Shqipërisë”(TALGA).
4. Projektvendim “Për deklarimin e mbarimit para afatit, të mandatit të këshilltares Briseida Krenar Çakërri”

5. Projektvendim "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga djegia e banesës të z.Vllasi Proi dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë".
6. Projektvendim "Për miratimin e vlerës financiare të dëmeve të shkaktuara nga përmytja e banesës të z.Ëngjëll Mehmetaj dhe, shpërblimin financiar nga ana e Bashkisë Vlorë".
7. Projektvendim "Për miratimin e familjeve dhe individëve që përfitojnë subvencionin e qirasë në treg të lirë dhe, vlerat e subvencionit të qirasë për çdo rast".
8. Projektvendim "Për miratimin e dhënies së grantit të menjëhershëm nga buxheti i shtetit, familjeve që kanë përfituar strehim në banesat e ndërtuara nga Enti Kombëtar i Banesave".
9. Projektvendim "Për miratimin e kërkesës për shpenzime për ushtrimin e funksionit të Këshillit të Bashkisë Vlorë, për vitin 2026".
10. Projektvendim "Për miratimin e Programit të Punës së Aktiviteteve të Këshillit të Bashkisë Vlorë, për periudhën Janar – Dhjetor 2026".
11. Të Ndryshme .

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë, datë 20.11.2025, ora 11:00.

Komisionet e përhershme, do të mbledhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :

Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mbledhet ditën e martë , datë 25.11.2025 , ora 09:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.11.2025, ora 10:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e martë, datë 25 .11.2025, ora 11:00.

Komisioni i mandateve dhe rregullores, do të mbledhet ditën e martë, datë 25.11.2025 , ora 12:00.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR
Elpiniq Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORE
KËSHILLI I BASHKISË ✓

Nr. 19528 Prot.

Vlorë, më 20.11.2025

VENDIM

Nr 13, datë 20.11.2025

“MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN E RADHËS”

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 53, Neni 56, pika 2/a dhe, Rregulloren “Për Organizmin dhe Funkcionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” Neni 58 dhe 59, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 20.11.2025,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen e radhës së Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 27.11.2025.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

